



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 05.11.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2017, PËR PROJEKTIN “PROMOVIMI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME PËRMES FONDIT TË GARANCISË SË KREDIVE RURALE”

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 05.11.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale” në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantoi projektligjin, Z. Ilir Halilaj, Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Z. Pjerin Shoshi, Drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Znj. Edlira Llango, Drejtore Juridike dhe Znj. Elma Vathi, Shefe e Sektorit të Koordinimit dhe Integritimit.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji, ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Projekti ka si objektiv të inkurajojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mbi një bazë të qëndrueshme, duke u dhënë mundësinë për të krijuar vende të reja pune, të rriten dhe të bëhen më konkurruese.

Ratifikimi këtij projektligji do të forcojë marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve nëpërmjet bashkëpunimit financiar.

Marrëveshja parashikon një bashkëpunim që do të ofrojë një kontribut shumë të rëndësishëm në promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet fondit të garancisë, duke garantuar kreditë ndërkombëtare të institucioneve mikrofinanciare, të cilat do t`u ofrojnë kredi kredimarrësve në segmentin bujqësor e rural të ekonomisë.

Marrëveshja konsiston në përdorimin e shumës së financimit me vlerë të përgjithshme 5 000 000 (pesë milion) euro.

Kjo shumë do të zhvlerësohet në rast se kontratat përkatëse të financimit nuk lidhen deri me 31 dhjetor 2018.

Diskutimet në Komision :

Deputetët në komision pasi u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit bazuar në pyetjet dhe përgjigjet e marra nga përfaqësuesit e ministrive, ndalën dhe diskutuan mbi çështjen e taksave, prej të cilat përjashtohet KfW. Deputetët kërkuan që relacionit shoqërues të projektligjit t`i shtohet dhe një listë, ku të përcaktohen qartë taksat konkrete prej të cilave marrëveshja përjashton KfW-në. Pas shqyrtimit të projektligjit, Komisioni e votoi dhe miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale” është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 “Për Marrëveshjet ndërkombëtare.”

Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI